



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) - NR. 02/ 2024 PËR  
PARANDALIMIN DHE NDALIMIN E FORMAVE TË RREZIKSHME  
TË PUNËS SË FËMIJËVE NË KOSOVË<sup>1</sup>**

---

<sup>1</sup> Udhëzimi Administrativ (QRK) nr. 02/2024 për Parandalimin dhe Ndalimin e Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve në Kosovë, është miratuar në mbledhjen e 198 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendimin nr. 07/198, të datës 02.04.2024

## **Qeveria e Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 8, paragrafit 4, nën paragrafit 4.5 të Ligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 50, paragrafit 6 të Ligjit Nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës si dhe nenin 19, paragrafin 6.2 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare, Nr.15, 12.09.2011),

Nxjerr:

### **UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK)-NR. 02/2024 PËR PARANDALIMIN DHE NDALIMIN E FORMAVE TË RREZIKSHME TË PUNËS SË FËMIJËVE NË KOSOVË**

#### **KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJTHSHME**

##### **Neni 1 Qëllimi**

1.Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i formave për parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve në Republikën e Kosovës.

2.Ky Udhëzim Administrativ po ashtu përcakton masat dhe veprimet që kërkohen të ndërmerren nga institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal, si dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse lidhur me parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve.

##### **Neni 2 Fushëveprimi**

Ky Udhëzim Administrativ vlen për të gjitha institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, dhe për të gjithë personat në të gjitha fazat e parandalimit dhe ndalimit të formave të rrezikshme të punës së fëmijëve.

##### **Neni 3 Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimet e përcaktuara në Ligjin përkatës për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës.

#### **Neni 4**

##### **Parimet Udhëheqëse**

Në të gjitha veprimet dhe masat e parapara në këtë Udhëzim Administrativ, institucionet përgjegjëse udhëhiqen, duhet të kenë parasysh dhe të zbatojnë me prioritet parimet bazë të përcaktuara në Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, për të siguruar që jeta, dinjiteti dhe integriteti i fëmijës është i garantuar dhe mbrojtur në çdo moment.

#### **Neni 5**

##### **Parandalimi**

1. Institucionet përgjegjëse duhet të ndërmarrin të gjitha masat dhe veprimet nëpërmjet të cilave parandalohen veprimet që rrezikojnë mirëqenien dhe interesin e fëmijës përfshirë pjesëmarrjen në aktivitetet apo ambientet e përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ.

2. Institucionet përgjegjëse duhet të ndërmarrin masat e nevojshme profesionale dhe ligjore nëpërmjet të cilave promovojnë të drejtat e fëmijës, ngritjen e vetëdijes dhe edukimit të fëmijëve, prindërve dhe shoqërisë në përgjithësi, nxjerrjen e politikave pro aktive dhe masave për adresimin e nevojave të grupeve të cenuara dhe diskriminuara, prindërve dhe mbështetjen e familjeve.

#### **Neni 6**

##### **Reagimi dhe ndalimi**

1. Institucionet përgjegjëse duhet të reagojnë për të parandaluar dhe ndaluar pjesëmarrjen e fëmijëve në forma të punëve të rrezikshme.

2. Institucionet përgjegjëse duhet që në mënyrë aktive të realizojnë aktivitete konkrete me qëllim që të sigurojnë që të parandalohen dhe ndalohen fëmijët në forma të punëve të rrezikshme.

## **KAPITULLI II**

### **PUNA E RREZIKSHME E FËMIJËS**

#### **Neni 7**

##### **Format e rrezikshme të punës së fëmijës**

1. Format e rrezikshme të punës së fëmijës për ndalim të menjëhershëm përfshijnë por nuk kufizohen në forma të punës si në vijim:

1.1.aktivitetet e përgjithshme:

1.1.1.puna prej orës 22:00 deri ora 06:00;

1.1.2. për fëmijët që nuk kanë të themeluar marrëdhënie pune por janë të angazhuar në

aktivitete të ndryshme që kanë për qëllim përfitim ekonomik, me prioritet ndalohet puna e natës ndërmjet orës 20:00 deri më 08:00;

1.1.3.ngritja dhe bartja e kohëpaskohshme e peshave të rënda mbi 15 kg (M) dhe 10 kg (F);

1.1.4.ngritja dhe bartja e vazhdueshme e peshave mbi 10 kg (M) dhe 5 kg (F);

1.1.5.puna në thellësi, nën sipërfaqe të tokës, nën ujë dhe vende të mbyllura;

1.1.6.puna në lartësi mbi 2 m;

1.1.7. ekspozimi ndaj temperaturave ekstreme të larta apo të ulëta;

1.1.8.ekspozimi ndaj zhurmës dhe dridhjes;

1.1.9.ekspozimi ndaj substancave toksike;

1.1.10.ekspozimi ndaj substancave biologjike;

1.1.11.ekspozimi ndaj radioaktivitetit;

1.1.12.ekspozimi ndaj substancave kancerogjene, pluhurit dhe gazrave;

1.2.sektorët me rrezikshmëri të lartë:

1.2.1.bujqësia dhe pylltaria;

1.2.2.ndërtimtaria;

1.2.3.puna në eksploatimin e pasurive natyrore;

1.2.4.puna në deponi të mbeturinave;

1.2.5.puna në rrugë;

1.2.6.puna në teknologjinë informative;

1.2.7.puna në hotelieri, klube të natës, lojëra të fatit dhe argëtimit.

2.Ndalesat sipas paragrafit 1 të këtij neni vlejné dhe janë të obligueshme si për sektorin formal, po ashtu edhe për atë jo formal.

3.Ndalesat specifike për sektorët sipas paragrafit 1, nënparagrafi 1.2 janë në shtojcën 1 e cila është pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi.

**Neni 8**  
**Masat për parandalimin e angazhimit dhe përfshirjes**  
**të fëmijës në punë të rrezikshme**

1. Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës janë njëkohësisht proaktive dhe reaguese, ndaj shërbimeve lidhur me parandalimin ashtu edhe me përgjigjen ndaj situatave të përfshirjes së fëmijës në punë të rrezikshme.
2. Në kuadër të përgjegjësive dhe obligimeve të tyre, institucionet përkatëse janë të obliguara:
  - 2.1. të bëjnë monitorimin e situatës së fëmijës në punë në baza vjetore me qëllim identifikimin e mangësive në sistemin e mbrojtjes së fëmijës dhe planifikimin e masave për adresimin e tyre;
  - 2.2. të bëjnë vlerësime të rregullta vjetore në nivel komune dhe vendi për të identifikuar trendet e punësimit të fëmijës, shkaqet dhe pasojat në jetën e fëmijës, familjes dhe në nivel të gjithë shoqërisë;
  - 2.3. të zbatojnë iniciativa që promovojnë mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijës në vazhdimësi, si dhe të përkushtohen në ndërgjegjësimin e popullatës së përgjithshme dhe grupeve të veçanta të popullatës për pasojat negative të punës së fëmijës dhe pasojat ligjore të shfrytëzimit të fëmijës në forma të rrezikshme të punës;
  - 2.4. që të përpilojnë udhëzues informues për fëmijët lidhur me punët e rrezikshme dhe qëndrimin e tyre në ambiente të punës së rrezikshme për moshën e tyre, si dhe udhëzues informues për institucionet, ndërmarrjet private lidhur me punët dhe ambientet e punës së rrezikshme për fëmijët dhe dëmet që mund t'i shkaktohen fëmijës.
3. Çdo institucion përgjegjës, gjatë hartimit dhe vlerësimit të politikave, legjislacionit dhe dokumenteve strategjike, duhet që të eliminojë çfarëdo mundësie që fëmija të ekspozohet ndaj formave të rrezikshme të punës.

**Neni 9**  
**Masat për kontrollin e fëmijës në punë**  
**të rrezikshme dhe prezencën e tyre në**  
**ambientet e punës së rrezikshme**

1. Masat për kontrollin e fëmijës, për parandalimin e prezencës dhe punës së rrezikshme përfshijnë, por nuk kufizohen në:
  - 1.1. vizitat e inspektoratit të punës në terren, me qëllim të parandalimit dhe ndalimit të formave të rrezikshme të punës së fëmijës;
  - 1.2. vizitat e inspektoratit të nivelit qendror dhe atij lokal në terren me qëllim të eliminimit, parandalimit dhe ndalimit të formave të rrezikshme të punës së fëmijëve.

## **KAPITULLI III**

### **ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E MEKANIZMAVE INSTITUCIONAL**

#### **Neni 10**

##### **Roli i Ministrisë së Drejtësisë**

1. Roli dhe përgjegjësia e Ministrisë së Drejtësisë në parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës përfshin, por nuk kufizohet në:

- 1.1. vlerësimin në baza periodike të zbatimit të legjislacionit që i referohet parandalimit dhe ndalimit të formave të rrezikshme të punës së fëmijës;
- 1.2. propozimin e ndryshimit dhe plotësimit të legjislacionit sipas vlerësimit të zbatimit të legjislacionit përkatës që i referohet parandalimit dhe ndalimit të formave të rrezikshme të punës së fëmijës dhe pengesave në praktikë;
- 1.3. nxjerrjen e udhëzuesve praktikë për zbatimin e legjislacionit përkatës që i referohet parandalimit dhe ndalimit të formave të rrezikshme të punës së fëmijës;
- 1.4. përfshirjen e parandalimit dhe ndalimit të formave të rrezikshme të punës së fëmijëve në politikat, legjislacionin dhe dokumentet strategjike përkatëse;
- 1.5. konsolidimin e të dhënave vjetore mbi trendët e punës së fëmijëve në sektorët dhe/apo rajonet specifike, shërbimet ekzistuese të ofruara për ta dhe mungesën e shërbimeve apo pengesat në qasje dhe nxjerrjen e rekomandimeve për adresimin e problemeve;
- 1.6. koordinimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve për parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve me institucionet dhe mekanizmat relevant, sektorin privat dhe organizatat e shoqërisë civile që në fokus kanë mbrojtjen e fëmijës;
- 1.7. mbështetjen e institucioneve relevante dhe akterëve tjerë sipas pikës 1.6. të këtij neni në zbatimin e legjislacionit përkatës në fuqi për parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës.

#### **Neni 11**

##### **Roli i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si dhe drejtorive komunale përkatëse**

1. Roli dhe përgjegjësia e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe drejtorive komunale përkatëse në parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës përfshinë por nuk kufizohet në:

- 1.1. organizimin e fushatave sensibilizuese dhe vetëdijesuese me fermerë për format e rrezikshme të punës së fëmijës në bujqësi dhe pylltari dhe për masat mbrojtëse;
- 1.2. këshillimin e drejtpërdrejtë të fermerëve për format e rrezikshme të punës së fëmijës në bujqësi dhe pylltari dhe për masat e mbrojtjes;

1.3. përfshirjen e ndalesës së angazhimit të fëmijëve në forma të rrezikshme të punës në bujqësi dhe pylltari në kuadër të kontratave me persona juridik dhe fizik;

1.4. adresimin adekuat në kuadër të legjislacionit përkatës të bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural për format e rrezikshme të punës së fëmijëve.

## **Neni 12**

### **Roli i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe të drejtorive komunale përkatëse**

1. Roli i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës përfshinë, por nuk kufizohet në:

1.1. adresimin e parandalimit dhe ndalimit të përfshirjes së fëmijëve në punë të rrezikshme përmes legjislacionit, politikave, dokumenteve strategjike si dhe masave të tjera të nevojshme.

1.2. adresimin e parandalimit dhe ndalimit të përfshirjes së fëmijëve në punë të rrezikshme, duke e trajtuar këtë tematikë me qasje kurrikulare, ndërkurrikulare dhe ekstrakurrikulare;

2. Roli i Drejtorisë Komunale përkatëse për Arsim në parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës përfshinë, por nuk kufizohet në:

2.1. edukimin e fëmijës për të drejtat e tyre, për rreziqet nga aktivitete të ndryshme punuese, për përgjegjësitë e prindit apo kujdestarit dhe shtetit për të siguruar mirëqenien e fëmijës, edukimin dhe shkollimin, përmes aktiviteteve shkollore;

2.2. përcjelljen e gjendjes psiko-fizike të fëmijës për të cilin ka dyshime se është përfshirë në forma të rrezikshme të punës;

2.3. evidentimin dhe referimin në qendër për punë sociale dhe në polici për rastet e fëmijës së përfshirë në forma të rrezikshme të punës;

2.4. mbështetje e riintegritit dhe risocializimit, gjatë procesit të tërheqjes së fëmijës nga puna e rrezikshme;

2.5. organizimin e aktiviteteve sensibilizuese dhe vetëdijësuese për format e rrezikshme të punës së fëmijës përmes takimeve individuale e grupore me fëmijë, prindër, mësimdhënës, dhe përmes mediave, materialeve informative, takimeve të drejtpërdrejta informuese dhe këshilluese.

## **Neni 13**

### **Roli i Ministrisë së Shëndetësisë dhe të drejtorive komunale përkatëse**

1. Roli i Ministrisë Shëndetësisë në parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës përfshinë, por nuk kufizohet në:

1.1.adresimin e parandalimit dhe ndalimit të përfshirjes së fëmijëve në punë të rrezikshme përmes legjislacionit, politikave, dokumenteve strategjike si dhe masave të tjera të nevojshme.

2. Roli i Drejtorisë Komunale përkatëse për Shëndetësi përfshin, por nuk kufizohet në:

2.1.evidentimin e rastit të identifikuar të fëmijës që ka kërkuar shërbim mjekësor për shkak të lëndimit në punë;

2.2. evidentimin e rasteve të dyshuara gjatë vizitave të rregullta, sistematike familjare dhe shkollore;

2.3. referimin e rasteve të evidentuara në njësitë përkatëse të policisë dhe qendrës për punë sociale;

2.4. ofrimin e ndihmës emergjente shëndetësore të fëmijës të lënduar në punë;

2.5 organizimin e aktiviteteve sensibilizuese dhe vetëdijesuese për efektet negative të punës së rrezikshme të fëmijës në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës.

#### **Neni 14**

#### **Roli i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve**

Roli i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës përfshinë, por nuk kufizohet në adresimin e parandalimit dhe ndalimit të përfshirjes së fëmijëve në punë të rrezikshme përmes legjislacionit, politikave, dokumenteve strategjike si dhe masave të tjera të nevojshme.

#### **Neni 15**

#### **Roli i Inspektoratit të Punës**

1. Roli dhe përgjegjësia e Inspektoratit të Punës në parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës përfshin, por nuk kufizohet në:

1.1. ndërmarrjen e veprimeve inspektuese për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ dhe legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës;

1.2. referimin e rasteve të identifikura të fëmijës së angazhuar në punë të rrezikshme në njësitë përkatëse të policisë dhe qendrës për punë sociale;

1.3. inspektimin mbi baza periodike dhe të paparalajmëruar në mjediset e punës me qëllim të parandalimit dhe ndalimit të formave të rrezikshme të punës së fëmijës;

1.4. inspektimin në bazë të informatave të pranuar, me qëllim të parandalimit dhe ndalimit të formave të rrezikshme të punës së fëmijës.



## **Neni 16**

### **Roli i Zyrës për Qeverisje të Mirë**

1. Roli dhe përgjegjësia e Zyrës për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit në parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës përfshinë, por nuk kufizohet në:

1.1. ofrimin e këshillave për Kryeministrin dhe ministrinë lidhur me parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës;

1.2. mbikëqyrjen e ministrive përkatëse në parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës nga këndvështrimi i qeverisjes së mirë;

1.3. përfshirjen e parandalimit dhe ndalimit të formave të rrezikshme të punës së fëmijës përgjatë hartimit të politikave në sferën e qeverisjes së mirë;

1.4. ofrimin e rekomandimeve Kryeministrit dhe ministrive përkatëse, shqyrtimin e politikave, projekt legjislacionit të përgatitur nga organet qeveritare në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut në fuqi dhe të praktikave të qeverisjes së mirë lidhur me parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës;

1.5. ofrimin e ndihmës në zhvillimin e fushatave të komunikimit me publikun dhe të projekteve të tjera promovuese për të nxitur vetëdijësimin e popullatës mbi parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës;

1.6. konsultimin me përfaqësuesit dhe grupet e ndryshme të interesit, dhe sipas nevojës krijimin e organeve këshillëdhënëse për parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës.

## **Neni 17**

### **Roli i Komitetit Ndërministror për të Drejtat e Fëmijës**

1. Roli dhe përgjegjësia e Komitetit Ndërministror për të Drejtat e Fëmijës në parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës përfshin, por nuk kufizohet në:

1.1. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave dhe legjislacionit që i referohet parandalimit dhe ndalimit të formave të rrezikshme të punës së fëmijës;

1.2. koordinimin e aktiviteteve të të gjitha institucioneve dhe mekanizmave që janë në funksion të parandalimit dhe ndalimit të formave të rrezikshme të punës së fëmijës;

1.3. mbledhjen e raporteve nga ministrinë dhe përpunimin e tyre me qëllim të adresimit të tyre për ndryshimin e gjendjes në parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës;

1.4. përcaktimin e prioriteteve të intervenimit për parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës.

## **Neni 18**

### **Roli i Policisë së Kosovës**

1. Roli dhe përgjegjësia e Policisë së Kosovës në parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës përfshinë, por nuk kufizohet në:

1.1. zbatimin e legjislacionit që i referohet parandalimit dhe ndalimit të formave të rrezikshme të punës së fëmijës konform mandatit të përcaktuar në legjislacionin përkatës të policisë;

1.2. inicimin e procedurës penale dhe zhvillimin e hetimeve ndaj personave që kanë shkelur legjislacionin përkatës për parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës;

1.3. patrullimin dhe kontrollimin e ambienteve të caktuara, kur ekziston dyshimi i bazuar se fëmija mund të jetë i përfshirë në forma të rrezikshme të punës;

1.4. ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes konform mandatit që ka për institucionet tjera që kanë mandat parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës;

1.5. ofrimin e bashkëpunimit ndër institucional me qëllim parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës.

## **Neni 19**

### **Roli i Komunës**

1. Roli dhe përgjegjësia e Komunës në parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës përfshin, por nuk kufizohet në:

1.1. përfshirjen e parandalimit dhe ndalimit të formave të rrezikshme të punës së fëmijës në kuadër të akteve relevante që nxjerr komuna;

1.2. krijimi i mekanizmave për mbikëqyrjen e situatës së punës së fëmijës dhe efektivitetit të masave dhe shërbimeve në dispozicion për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga format e rrezikshme të punës së fëmijës brenda territorit të Komunës;

1.3. mobilizimi i inspektorateve që janë në përgjegjësi të komunës që të jenë në funksion të parandalimit dhe ndalimit të formave të rrezikshme të punës së fëmijës;

1.4. qasje proaktive në vlerësimin e kushteve dhe rrethanave që mund të inkurajojnë përfshirjen e fëmijës në forma të rrezikshme të punës;

1.5. shqyrtimi i të dhënave të mbledhura në terren nga mekanizmat përkatës dhe përcaktimi i prioritetëve vjetore të intervenimit për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga format e rrezikshme të punës, duke përfshirë përmirësimin e politikave që kanë të bëjnë me eliminimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës;

1.6. kordinimi i aktiviteteve dhe bashkëpunimi i ngushtë me organizatat e shoqërisë civile me qëllim të parandalimit dhe ndalimit të formave të rrezikshme të punës së fëmijës;

1.7. organizimi i aktiviteteve promovuese për të nxitur vetëdijësimin e popullatës mbi parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës.

## **Neni 20** **Roli i Qendrës për Punë Sociale**

1. Roli dhe përgjegjësia e Qendrës për Punë Sociale në parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës përfshin; por nuk kufizohet në:

1.1. vlerësimin profesional për secilin fëmijë kur ka informacion se fëmija është përfshirë në forma të rrezikshme të punës;

1.2. kryerjen e vizitave të rregullta, sipas detyrës zyrtare, në komunitet, familje dhe shkolla me qëllim të parandalimit dhe ndalimit të formave të rrezikshme të punës së fëmijës;

1.3. vlerësimin e rrezikut të mundshëm që një fëmijë mund të jetë viktimë e formave të rrezikshme të punës;

1.4. menaxhimin e rasteve konkrete për parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës;

1.5. trajtimin e çdo rasti individual që referohet në QPS për mbrojtje nga format e rrezikshme të punës së fëmijës përmes TMR-së;

1.6. zbatimin e legjislacionit përkatës në fuqi dhe standardeve minimale, me qëllim të parandalimit dhe ndalimit të formave të rrezikshme të punës së fëmijës;

1.7. përditësimin dhe menaxhimin e të dhënave të regjistruara në bazën e të dhënave për rastet e parandalimit dhe ndalimit të formave të rrezikshme të punës së fëmijës;

1.8. koordinimin e aktiviteteve me institucionet e tjera me qëllim të parandalimit dhe ndalimit të formave të rrezikshme të punës së fëmijës.

## **Neni 21** **Roli i Ekipit për të** **Drejtat e Fëmijës**

1. Roli dhe përgjegjësia e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës në parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës përfshinë, por nuk kufizohet në:

1.1. mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit që ka për qëllim parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës;

1.2. përfshirjen e aktiviteteve konkrete në parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës në kuadër të planit të punës së Ekipit për të Drejtat e Fëmijës;

1.3. ofrimin e këshillave për institucionet tjera me qëllim parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës;

1.4. mobilizimin e institucioneve përkatëse që ofrojnë shërbime për fëmijë për identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës (përfshirë format tjera më të rënda të punës së fëmijës);

1.5. vlerësimi i vazhdueshëm në bazë gjashtëmujore i efektivitetit të masave ekzistuese në nivelin lokal, përfshirë nivelin e reagimit të institucioneve relevante;

1.6. dokumentimi i vazhdueshëm në bazë vjetore i trendeve dhe shtrirjes së punës së fëmijëve në komunën përkatëse;

1.7. ofrimi i rekomandimeve për prioritetet vjetore të intervenimit në nivel komune;

1.8. ofrimi i rekomandimeve për zhvillim/avansim të vazhdueshëm të politikave në nivel lokal dhe qendror;

1.9. raportimin për çdo rast kur ka informata se një fëmijë është viktimë e punës së rrezikshme;

1.10. koordinimin si dhe referimin e rastit tek mekanizmat e tjerë për trajtim të mëtutjeshëm të rastit të identifikuar;

1.11. analizimin e të dhënave për situatën e punës së fëmijës, duke përfshirë:

1.11.1. numrin e fëmijëve të përfshirë në forma të rrezikshme të punës;

1.11.2. ndarjen sipas sektorëve dhe rajoneve gjeografike;

1.11.3. nevojat e fëmijëve të përfshirë në forma të rrezikshme të punës dhe familjeve të tyre;

1.11.4. shërbimet ekzistuese të ofruara për tërheqjen dhe mbrojtjen e fëmijës të përfshirë në forma të rrezikshme të punës;

1.11.5 mungesën e shërbimeve apo pengesat në qasje.

1.12. Të dhënat që rrjedhin nga analiza sipas nënparagrafit 1.11 të këtij neni, shërbejnë për vendosjen e objektivave dhe aktiviteteve konkrete në kuadër të planit të punës së ekipit.

## **KAPITULLI IV MASAT PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE**

### **Neni 22 Identifikimi dhe referimi fillestar**

1. Identifikimi mund të vijë si pasojë e dyshimit apo shqetësimit për përfshirjen e fëmijës në punë të rrezikshme.
2. Çdo person është i detyruar për të raportuar dhe referuar çdo informatë të pranuar në lidhje me dyshimin se një fëmijë është përfshirë në forma të rrezikshme të punës.
3. Identifikimin dhe referimin mund ta bëjë edhe fëmija për fëmijën, si dhe fëmija për vetëveten.

### **Neni 23** **Procedura e raportimit dhe** **menaxhimit të rastit**

1. Çdo institucion dhe person që identifikon një fëmijë që është në rrezik apo është viktimë e përfshirjes në njërin prej formave të rrezikshme të punës, siç përcaktohet me legjislacionin përkatës në fuqi dhe me këtë Udhëzim Administrativ, duhet që ta njoftoj Policinë apo Qendrën për Punë Sociale kompetente.
2. Pas referimit të fëmijës si viktimë e njëres prej formave të rrezikshme të punës, Qendra për Punë Sociale është përgjegjëse për verifikimin e rastit.
3. Në rastet kur Qendra për Punë Sociale vërteton informatën për përfshirjen e fëmijës në punë të rrezikshme, duhet të bëjë vlerësimin e rastit dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës.
4. Qendra për Punë Sociale sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet që të njoftoj Policinë e Kosovës, Inspektoratin e Punës dhe Administratën Tatimore të Kosovës për veprime të mëtejme në të gjitha rastet, sipas përgjegjësisve përkatëse.
5. Në rastet kur fëmija është angazhuar në punë të rrezikshme në një komunë tjetër nga komuna e vendbanimit, vlerësimi fillestar bëhet nga Qendra për Punë Sociale e komunës ku është identifikuar fëmija në bazë të kompetencës territoriale, dhe pas takimit të parë referohet në Qendrën për Punë Sociale të komunës së vendbanimit.
6. Menaxheri duhet të caktohet nga Qendra për Punë Sociale në komunën sipas vendbanimit më së largu 24 orë pasi vërtetohet se një fëmijë është i angazhuar në punë të rrezikshme. Në rastet kur fëmija është pa përkujdesje prindërore, Qendra për Punë Sociale duhet të caktojë një kujdestar ligjor.
7. Pas përfundimit të vlerësimit fillestar dhe gjithëpërfshirës, në bazë të vëzhgimit dhe bashkëbisedimit me fëmijën dhe/ose të rriturit që e shoqërojnë atë, menaxheri i rastit vlerëson nevojat dhe mënyrën e ndihmës së menjëhershme të fëmijës sipas nevojës;
8. Forma dhe mënyra e ndihmës së menjëhershme përcaktohet në varësi të gjendjes së përgjithshme shëndetësore, fizike, emocionale dhe të sigurisë së fëmijës dhe nivelit të rrezikut. Ndihma e menjëhershme mund të përfshijë:
  - 8.1. shoqërimin e fëmijës në familje kur vlerësohet se ambienti familjar nuk përbën rrezik për fëmijën;

- 8.2. shoqërimin e fëmijës për marrjen e shërbimeve ose vendosjen e fëmijës në shtëpinë për mbrojtjen e fëmijës sipas vlerësimit;
- 8.3. shoqërimin e fëmijës në shërbimin shëndetësor të urgjencës për fëmijë dhe vendosja në strehim familjar ose shtëpitë me bazë në komunitet.

9. Qendra për Punë Sociale është përgjegjëse që të udhëheqë procesin e menaxhimit të rastit dhe të njoftoj dhe caktoj takim me institucionet përgjegjëse për menaxhimin e rastit.

## **Neni 24**

### **Planifikimi dhe sigurimi i shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës**

1. Pas përfundimit të vlerësimit, për secilin fëmijë hartohet plani individual i shërbimeve nga menaxheri i rastit.
2. Përderisa Qendra për Punë Sociale, respektivisht menaxheri i rastit është përgjegjës për menaxhimin e shërbimeve që dalin nga plani e që janë në përputhje me interesin më të mirë të fëmijës, profesionistët tjerë të mbrojtjes së fëmijëve të përfshirë në rast, bartin poashtu përgjegjësitë e tyre në pajtim me mandatin që kanë.
3. Plani i shërbimeve përcakton objektivat individuale që janë drejtpërdrejt të rëndësishme për nevojat e fëmijës, të identifikuar gjatë vlerësimit, dhe të cilat përcaktojnë:
  - 3.1.masa dhe aktivitete specifike që janë shërbime të nevojshme për t'i adresuar nevojat e fëmijës;
  - 3.2.tregues të verifikueshëm për secilin aktivitet, në mënyrë që të pasqyrojë rezultatin e aktiviteteve të ndryshme;
  - 3.3.masat dhe aktivitetet bazuar në rolet dhe përgjegjësitë, si dhe afatet kohore.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e menaxherit të rastit janë:
  - 4.1. udhëheqë procesin për planifikimin e shërbimeve individuale për fëmijën, për të siguruar mbrojtjen, rehabilitimin, risocializimin dhe mirëqenien e fëmijës;
  - 4.2. identifikon shërbimet ekzistuese në komunë (përfshirë ato të sektorit publik, jo-qeveritar , dhe privat) dhe vendosë bashkëpunim për referimin e rastit të fëmijës së përfshirë në punë të rrezikshme apo familjarëve të tij/saj për shërbime të ndryshme varësisht nga nevojat e identifikuar;
  - 4.3. planifikon bashkëpunimet me shkollën dhe me ofruesit tjerë të shërbimeve, për të mbështetur në mënyrë reciproke ri-integrimin social dhe arsimor të fëmijës;
  - 4.4. planifikon hapa konkret për të mbështetur familjen në përmbushjen e përgjegjësiave për rritjen e fëmijës, duke iu ofruar mbështetje mbi prindërimin pozitiv.
5. Masat për përkujdesjen, ndihmën, rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijës janë përgjegjësi e ofruesve të shërbimeve në varësi të zgjidhjes afatgjate që është vlerësuar për fëmijën.

6. Masat sipas paragrafit 5 të këtij neni detajohen në planin individual të shërbimeve, ku janë të përcaktuara institucionet përgjegjëse dhe afatet kohore për ofrimin e shërbimeve.

7. Gjatë të gjitha fazave të procesit, institucionet përgjegjëse, nën mbikëqyrjen e menaxherit të rastit të fëmijës, duhet të sigurohen që shërbimet e ofruara t'u përgjigjen standardeve që kërkohen për mirëqenien e një fëmije.

### **Neni 25** **Dokumentimi, ruajtja dhe** **përpunimi i të dhënave**

1. Të gjitha institucionet dhe ofruesit e shërbimeve të përfshirë në raste të fëmijës në punë të rrezikshme duhet të mbajnë shënime për veprimet dhe shërbimet e ofruara nga vet ato.

2. Menaxheri i rastit në Qendrën për punë sociale përditëson dosjen fizike dhe elektronike me të dhënat nga procesi i menaxhimit të rastit.

3. Ministria e Drejtësisë krijon, mirëmban dhe menaxhon bazën e të dhënave me qëllim të evidentimit të çdo rasti kur fëmijët parandalohen dhe tërhiqen nga puna e rrezikshme.

## **KAPITULLI V** **ZBATIMI, MBIKËQYRJA DHE RISHIKIMI I LISTËS**

### **Neni 26** **Zbatimi**

1. Obligohen të gjitha institucionet e mandatuara sipas Ligjit përkatës për mbrojtjen e fëmijës dhe këtij Udhëzimi Administrativ të planifikojnë dhe ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e dispozitave të këtij udhëzimi.

2. Masat për zbatimin e këtij udhëzimi i referohen parandalimit, ndalimit, trajtimit të rasteve, bashkëpunimit ndër-institucional dhe monitorimit të rasteve sipas mandatit ligjor.

3. Obligohen autoritetet përgjegjëse që t'i zbatojnë procedurat standarde të veprimit për monitorimin e punës së fëmijëve në format e rrezikshme të punës së fëmijës.

### **Neni 27** **Mekanizmat për mbikëqyrje të zbatimit**

1. Mekanizmat për mbikëqyrjen së zbatimit të dispozitave të këtij udhëzimi dhe legjislacionit për të drejtat e fëmijës në nivel qendror, në pajtim me mandatin që kanë, janë:

1.1. Institucioni i Avokatit të Popullit;

1.2. Ministrinë përkatëse sipas fushës që mbulojnë;

- 1.3. Njësia përkatëse për Qeverisje të Mirë, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit;
  - 1.4. Komiteti Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijës;
  - 1.5. Policia e Kosovës;
  - 1.6. Këshilli për të Drejtat e Fëmijës.
2. Çdo institucion qendror i mandatuar për zbatim të këtij Udhëzimi Administrativ është i obliguar që të raportojë tek Komiteti Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijës për masat e ndërmarra për zbatim.
3. Mekanizmat e mbikëqyrjes së zbatimit të dispozitave të këtij udhëzimi dhe legjislacionit për të drejtat e fëmijës në nivel lokal janë:
- 3.1. Komuna dhe organet e saj;
  - 3.2. Departamenti përkatës sipas fushës që mbulon në lidhje me të drejtat e fëmijës;
  - 3.3. Qendra për Punë Sociale;
  - 3.4. Ekipi për të Drejtat e Fëmijës.
4. Çdo institucion përgjegjës për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ në nivelin lokal obligohet që të raportojë për masat e zbatuara tek Ekipi për të Drejtat e Fëmijës.
5. Udhëheqësi i Ekipit për të drejtat e fëmijës është i obliguar që në bazë vjetore t'i raportojë Kuvendit të Komunës për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ në komunën përkatëse.

**Neni 28**  
**Rishikimi i listës së formave të rrezikshme**  
**të punës së fëmijës**

Lista e formave të rrezikshme të punës së fëmijës duhet të plotësohet dhe ndryshohet, pas vlerësimit të nevojave dhe krijimit të rrethanave të reja, që identifikojnë forma të reja që nuk janë pjesë e listës.

**Neni 29**  
**Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve profesionale në fushën**  
**e parandalimit dhe ndalimit të punëve**  
**të rrezikshme për fëmijët**

Ministritë përkatëse janë përgjegjëse për ngritjen dhe zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale për stafin e institucioneve përkatëse që kanë të bëjnë me parandalimin dhe ndalimin e punëve të rrezikshme për fëmijën.



**KAPITULLI VI**  
**DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

**Neni 30**  
**Udhëzuesit**

1. Ministria e Drejtësisë brenda gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ nxjerr:

1.1. Udhëzuesin për menaxhimin e rastit të fëmijës në punë të rrezikshme;

1.2. Procedurat standarde të veprimit për parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijës.

**Neni 31**  
**Shtojca**

1. Pjesë e këtij Udhëzimi është shtojca si në vijim:

1.1.Shtojca nr.1: Lista e sektorëve dhe aktiviteteve të rrezikshme të punës së fëmijës në Kosovë.

**Neni 32**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2013 për parandalimin dhe eliminimin e punëve më të rrezikshme për fëmijët në Kosovë.

**Neni 33**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës

**Albin KURTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

02 maj 2024



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*

---

**LISTA E SEKTORËVE DHE AKTIVITETEVE TË RREZIKSHME TË  
PUNËS SË FËMIJËS NË KOSOVË**

**LISTA E AKTIVITETEVE TË PËRGJITHSHME PËR NDALIM TË MENJËHERSHËM**

1. Ndalohen të gjitha format e punës prej orës 22:00 deri në ora 06:00
2. Ngritja dhe bartja e kohëpaskohshme e peshave të rënda mbi 15 kg (M) dhe 10 kg (F)
3. Ngritja dhe bartja e vazhdueshme e peshave mbi 10 kg (M) dhe 5 kg (F)
4. Puna në thellësi, nën sipërfaqe të tokës, nën ujë dhe vende të mbyllura
5. Puna në lartësi mbi 2 metra
6. Ekspozimi ndaj temperaturave ekstreme të larta apo të ulëta, ndaj zhurmës dhe dridhjes
7. Ekspozimi ndaj substancave toksike
8. Ekspozimi ndaj substancave biologjike
9. Ekspozimi ndaj radioaktivitetit
10. Ekspozimi ndaj substancave kancerogjene, pluhurit dhe gazrave

**SEKTORËT PËR NDALIM TË MENJËHERSHËM PËR FËMIJËT DERI NË MOSHËN  
18 VJEÇ**

<b>BUJQËSIA DHE PYLLTARIA</b>	<b>NDËRTIM TARIA</b>	<b>PUNA NË EKSPLOATI MIN E PASURIVE NATYRORE</b>	<b>PUNA NË DEPONI TË MBETURIN AVE</b>	<b>PUNA NË RRUGË</b>	<b>PUNA NË TEKNOL OGJINË INFORM ATIVE</b>	<b>PUNA NË HOTELI ERI, KLUBE TË NATËS, LOJËRA TE FATIT DHE ARGËTI MIT</b>
Puna në ujitje me sistem pompimi dhe kur burim i ujit janë puset	Gërmimi i dheut	Gërmimet sipërfaqësore të thëngjillit, rërës dhe gurëve	Klasifikimi i mbeturinave në deponitë e mbeturinave apo në kontejnerë	Shitja e mallrave në rrugë	Puna online që ndikon në largimin nga edukimi dhe arsimimi	Puna në hotele dhe restorante ku shërbehet alkooli
Operimi me makina bujqësore dhe mekanizëm bujqësor bashkëngjitur dhe përcjellës	Transportimi i peshave të rënda	Eksplorimi i thëngjillit, rërës dhe gurëve	Grumbullimi i mbeturinave në deponitë e mbeturinave apo në kontejnerë	Transportimi i mallrave me karrocë		Puna në klube të natës
Puna me pesticide dhe spërkatja	Sitja e rërës dhe çimentos		Bartja e materialit të grumbulluar në distanca të largëta	Pastrimi i parafangove të automjeteve në komunikacion		Puna në lojëra të fatit (fizike dhe online)
Puna në korrje, shirje dhe kositje	Puna në skele					Puna në qendrat rekreative dhe sportive
Puna me vegla bujqësore dhe hapja e gropave për mbjellje të pemëve	Përpunimi i metaleve					Puna në qendrat për lojëra zbavitëse

Puna në thertore dhe në industrinë e përpunimit të mishit						Puna në kinema apo teatër
Puna në serë						Puna në bare të ndryshme
Angazhimi në aktivitete të gjuetisë dhe peshkimit						Puna në kampingje dhe festivale për madhor
Punët silvi-kulturore në pyje, pyllëzime dhe mbrojtje nga zjarri						
Punët në shfrytëzimin e masës drusore dhe përpunimin primar të drurit						
Grumbullimi i produkteve jo-drusore në pyje						